

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
FAV Elektrik SHPK**

**PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**Neni 1
Ortaku**

Shoqëria është themeluar nga ortakët:

- 1) **Z. Vladimir KASTRATI**, shtetas shqiptar, i lindur në Krumë, Kukës, në datën 24/09/1985, mbajtës i letërnjoftimit nr. 028015547 dhe me numër personal I55924093S, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- 2) **Z. Ahmet KASTRATI**, shtetas shqiptar, i lindur në Krumë, Kukës, në datën 20/04/1991, mbajtës i letërnjoftimit nr. 031099973 dhe me numër personal J10420024H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar
- 3) **Z. Florenc Hasanaj**, shtetas shqiptar, i lindur në F Mamurras, në datën 18/02/1991, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034382601 dhe me numër personal J10218082R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

**Neni 2
Emri**

Emri i shoqërisë është **FAV Elektrik SHPK** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**Neni 3
Selia e Shoqerise**

- 3.1 Selia e Shoqerise do te jete ne adresen: Njesia bashkiake nr 7, rruga 29 Nentori, Godina nr 149, Tirane, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**Neni 4
Forma ligjore**

Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Neni 5



Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin e saj tregtar për një periudhë të pakufizuar.

Neni 6 Objekti i aktivitetit

- 6.3 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të konsistoj në të gjitha llojet e aktiviteteve sipas klasifikimit kombëtar të aktiviteteve, përveç atyre aktiviteteve për të cilat kërkohet miratimi ose akti i një organi shtetëror ose organi të autorizuar.
- 6.4 Fusha kryesore e aktivitetit do të jetë:

Kryerjen e veprimtarisë në fushën e ndertimit, studimit, projektimit, supervizimit, kolaudimit, konsulences, mirmbajtjes, shërbimeve, turizmit, prodhimit, importeksport, sipërmarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private. Ndertimin, prishjen dhe rikonstruksionin e godinave civile, objektet industriale, centraleve të ndryshme, objektet turistike, objektet me qëllim agroturizmin, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike etj. Ndertimin, mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvaj, metrove e pistave aeroportuale. Ndertimin, prishjen, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndertimet e nenstacioneve, kabinetet e transformatoreve linja e tensionit të ulët, mesëm e të lartë dhe shpërndarje të energjisë, si dhe çdo ndërtim tjetër që përben send të paluajshëm në përfundim. Import eksport, tregtim dhe furnizim me shumicë dhe pakicë të Energjisë Elektrike, pajisje elektrike dhe aparatura elektronike, produkte, mallra dhe lende të para të përdorimit industrial dhe të përgjithshëm, makineri, pajisje për përdorim industrial dhe të përgjithshëm, mobilje, pajisje zyre dhe mjete informatike etj. Import-eksport dhe tregtimin e të gjitha llojeve të materialeve, makinerive paisjeve dhe impianteve të ndryshme të karakterit elektrik, elektroshtepiak, elektronik, të telekomunikacionit, të destinuara për objekte civile dhe industriale. Prodhimin e paisjeve dhe makinerive të përmendura më sipër. Kryerjen e veprimtarive të shërbimit e riparimit të karakterit elektrik elektronik të Telekomunikacionit e të llojeve të tjera. Projektimin dhe zbatimin e projekteve të dhenien e konsulences, asistencës teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mesipërme. Ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike. Punime, germime, ndërtime e rikonstruksione në objekte civile dhe industriale. Prodhimin e paisjeve dhe makinerive të përmendura më sipër. Projektimin, supervizim dhe zbatimin e projekteve të dhenien e konsulences, asistencës teknike dhe kryerjen e shërbimeve në lidhje me veprimtaritë e mesipërme. Projektim dhe Instalim i impianteve elektrike, teknologjike, termike, hidrike, të ventilimit ftohje-ngrohjes (kondicionimit), furnizimit me gaz, i impianteve ngritëse dhe transportuese (ashensore, shkallelevizese, transportues), të sinjalistikës rrugore etj. Studime fizibiliteti në fushën e ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë me promovimin e

shkembimeve tregtare nga Shqiperia per jashte dhe nga jashte per ne Shqiperi. Kryerjen me menyre dytesore te cdo veprimtarie tregtare qe lidhet me permbushjen e objektit te saj tregtar dhe qe konsiderohet e nevojshme dhe e domosdoshme. Shoqeria ka te drejte te ushtroje cfaredolloj veprimtarie tjeter te lejuar nga ligji dhe ne perputhje me rregullat ne fuqi.

PJESA II KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT

Neni 7 Kapitali i Shoqërisë

- 7.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është **100,000 (njëqind) Lekë** dhe përbëhet nga 3 (tre) kuota. Pjesëmarrja e ortakëve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tyre si më poshtë:
- **Vladimir KASTRATI**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1(një) kuote me vlerë nominale 33,333.33 (tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre lek e tridhjetë e tre qindarka) që përbën 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Ahmet KASTRATI**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1(një) kuote me vlerë nominale 33,333.33 (tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre lek e tridhjetë e tre qindarka) që përbën 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 - **Florenc Hasanaj**, në cilësinë e ortakut themelues është zotërues i 1(një) kuote me vlerë nominale 33,333.33 (tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e tre lek e tridhjetë e tre qindarka) që përbën 33.33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

PJESA III ASAMBLEJA ORTAKEVE

Neni 8 Të drejtat e asamblesë së ortakëve

- 8.1. Asambleja e pergjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha çështjet e veprimtarisë së saj.
- 8.2. Asambleja e pergjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 8.3. Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) pranimin e ortakëve të rinj;
 - (c) largimin/përrjashtimin e një ortaku, në përputhje me dispozitat statutore në fuqi;
 - (d) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencioni të dhënë nga ortakët;
 - (e) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;



- (f) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
- (g) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
- (h) miratimin e raporteve vjetorë dhe bilancit të shoqërisë si dhe shpërndarjen e fitimit;
- (i) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
- (j) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejte për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
- (k) të vendosë për investimet;
- (l) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
- (m) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
- (n) të delegoj apo revokojë një procure apo autorizim për të vepruar në emër të shoqërisë;
- (o) të caktojë shpërblimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
- (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagese mbi largimin e drejtorëve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
- (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
- (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
- (s) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin;
- (t) të ngre padi kundër anëtarëve të organeve të shoqërisë ose kundër ortakëve të tjerë;
- (u) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
- (v) të marr hua;
- (w) përcaktimin e buxhetit vjetor;
- (x) miratimin e cdo çështje tjetër zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së përgjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.

Neni 9

Vendimet e asamblesë së ortakëve

- 9.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit të statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës. Vendimet për çështjet e tjera të renditura në nenin 8 të Statutit, merren me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës.
- 9.2. Në rastet kur Ortakët nuk marrin vendim në lidhje me çështjet e parashikuara nga neni 9.1., për të cilat kërkohet vendimarrje me shumicë të cilësuar, Shoqëria konsiderohet të ndodhet para rastit të ashtuquajtur Bllokim në Vendimarrje (“**Bllokim Vendimarrjeje**”). Në këtë rast, Ortakët angazhohen dhe bien dakord të caktojnë një mbledhje të dytë të Asamblesë së Përgjithshme, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga Mbledhja e mëparshme, ku të merren dhe një herë në shqyrtim çështjet për të cilat pati në Bllokim Vendimarrjeje në mbledhjen e mëparshme të Asamblesë së Përgjithshme.





- 9.3. Në rast se Ortakët, edhe në këtë mbledhje të dytë të Asamblesë së Përgjithshme nuk marrin vendim në lidhje me çështjet për të cilat kërkohet vendimmarrje, sërish në kushtet e Bllokimit në Vendimmarrje, atëherë do të procedohet me likuidimin e kuotës së Ortakut, i cili ka krijuar Bllokimin e Vendimmarrjes, sipas vlerës së tregut në shit-blerjen e kuotave në momentin e largimit të Ortakut.
- 9.4. Në mbledhjen e Asamblesë votimi do të kryhet i hapur. Në raste të vecanta, në varësi të çështjeve specifike, vendimi mund të merret më votim të fshehtë, në përputhje me dispozitat statutoare.

PJESA IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 10 Administrimi i Shoqërisë

- 10.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një administrator, i cili do të përfaqësojë individualisht Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e përgjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale administratorit.
- 10.2 Administratori mund të autorizojë palë të treta që t'i përfaqësojë ata në transaksione të vecanta.
- 10.3 Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ai është i autorizuar të përfaqësojë Shoqërinë në të gjitha çështjet që kanë lidhje me të.
- 10.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorit burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Përgjithshme dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.
- 10.5 Administratori ka të drejtat e mëposhtme:
- a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - c) marrja e huave në emër të shoqërisë dhe vendosja mbi kushtet e huasë;
 - d) përfundimin e marrëveshjeve mbi dhënien e huave;
 - e) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - f) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - g) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhënien dhe marrjen e paradhënies;



- h) dhënien e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
- i) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
- j) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërblimit të tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprejnë procedimet;
- k) administratori ka të drejtë të marrë cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- l) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
- m) administratori është përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
- n) administratori është përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
- o) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
- p) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
- q) administratori është përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
- r) marrin vendime mbi të gjitha çështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

10.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritjeje:

- 1) **1. Z. Florenc Hasanaj**, shtetas shqiptar, i lindur në F Mamurras, në datën 18/02/1991, mbajtës i letërnjoftimit nr. 034382601 dhe me numër personal J10218082R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar

PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 11 Viti financiar, pasqyrat vjetore financiare

11.1 Viti financiar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë financiar i Shoqërisë





fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.

- 11.2 Në fund të cdo viti financiar, administratorët do të përmbushin detyrat e mëposhtme:
- (a) përgatitjen e një liste të detajuar të asetëve të Shoqërisë dhe strukturës së tyre;
 - (b) përgatitjen e bilancit të shoqërisë i cili përshkruan situatën financiare të Shoqërisë;
 - (c) përgatitjen e llogarive të fitimit dhe të humbjeve.
- 11.3 Pasqyrat financiare të përgatitura do të paraqiten në mbledhjen e zakonshme të asamblesë së ortakëve së bashku me një raport të auditorëve të jashtëm për miratim.

Neni 12 Fitimi i Shoqërisë

- 12.1 Fitimi neto i Shoqërisë do të shpërndahet në përputhje me pjesët e kapitalit në Shoqëri, si më poshtë:
- a) 33.33% e fitimit do të shpërndahet tek ortaku Vladimir KASTRATI, si zotëruesi i një kuote, që përfaqëson 33.33 (tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre përqind) % të kapitalit të shoqërisë;
 - b) 33.33% e fitimit do të shpërndahet tek ortaku Ahmet KASTRATI, si zotëruesi i një kuote, që përfaqëson 33.33 (tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre përqind) % të kapitalit të shoqërisë;
 - c) 33.33% e fitimit do të shpërndahet tek ortaku Florenc HASANAJ, si zotëruesi i një kuote, që përfaqëson 33.33 (tridhjetë e tre pike tridhjetë e tre përqind) % të kapitalit të shoqërisë;
- 12.2 Fitimi neto do të jetë fitimi i Shoqërisë në përputhje me pasqyrat vjetore financiare të miratuara pas zbritjes së të gjitha taksave dhe caktimit të rezervave ligjore. Bilanci i shoqërisë do të miratohet nga asambleja e ortakëve dhe do të dorëzohet në organet tatimore përpara fundit të muajit Mars të vitit pasardhës.

PJESA VII PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 13 Prishja dhe likuidimi

- 13.1 Shoqëria do të zgjidhet në rastet e mëposhtme:



- (a) vendim i mbledhjes së asamblesë së ortakëve;
- (b) bashkimi me një shoqëri tjetër;
- (c) vendimi i gjykatës me juridiksion përkatës në rastet e parashikuara me ligj;
- (d) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara me ligj.

13.2 Likuidimi i Shoqërisë dhe shpërndarja e aseteve të Shoqërisë do të bëhet në përputhje me dispozitat ligjore.

PJESA VIII TE PERGJITHSHME

Neni 14 Te pergjithshme

- 14.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpiqen t'i zgjidhin ato miqësisht. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.
- 14.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 14.3 Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale.

ORTAKET


Vladimir KASTRATI



Ahmet KASTRATI



Florenc HASANAJ



Në Tiranë, më 27/01/2020